

Halim PURELLKU

**GAZETA "BORBA" MBI FAZËN E PARË TË KRYENGRITJES
SË PËRGJITHSHME SHQIPTARE
(PRILL-MAJ 1912)**

Gazeta "Borba", e përditshme politike, ekonomike dhe letrare, që botohej në vitin 1912 në Beograd, ashtu sikundër edhe vetë diplomacia serbe, ishte mjaft e angazhuar në observimin dhe vlerësimin e zhvillimeve politike në Shqipëri gjatë Kryengritjes së Përgjithshme shqiptare të vitit 1912, veçanërisht në Shqipërinë e Veriut, sepse Beogradi zyrtar këtë pjesë të Shqipërisë e konsideronte sferë të vet të interesit strategjik¹.

Gazeta "Borba" nëpërmjet korrespondentit të përhershëm nga Prizreni dhe të bashkëpunëtorëve nga këto anë, për së afërmi ndiqte zhvillimet politike dhe ato kryengritëse në Kosovë dhe përgjithësisht në Shqipërinë veriore. Ndaj dhe në faqet e edicioneve të kësaj gazete, të botuar gjatë muajve prill-maj 1912, hasim raporte, telegrame, letra dhe shkrime analitike të karakterit publicistik, nëpërmjet të cilave, lexuesit e saj dhe opinioni i gjerë njoftohej në masë të konsiderueshme e në mënyrë objektive, mbi shkaqet, shtrirjen gjeografike, rrjedhën dhe karakterin e kryengritjes, në fazën e parë të saj. Gjë që të dhënat faktografike, si dhe vlerësimet politike që i hasim në faqet e kësaj gazete janë në mënyrë plotësuese, edhe një referencë për pozitën dhe vlerësimin e drejtë të historiografisë shqiptare mbi: karakterin e përgjithshëm kombëtar; programin autonomist dhe mbi ekzistencën e një udhëheqjeje politike të vetme kombëtare të Kryengritjes së Përgjithshme shqiptare të vitit 1912². Ndaj dhe për këto çështje që trajtohen në këtë shkrim, në përputhshmëri me natyrën e këtij shkrimi-kontribut, gazeta "Borba" merr rëndësinë e burimit të dorës së parë. Por, me qëllim që të arrijmë në konkretësinë në

¹ *Srpska Akademija nauka i umetnosti, Odelene istorijski nauka, Dokumenti o spolnoj politici Kraljevine Srbije 1903-1914* (më tej: *Dokumenti o spoqoj politici Kraljevine Srbije...*), Knjiga V, Sveska 1, 1/14. Januar-14/27, Juli 1912, Priredio Mihajlo Vojvodi, Beograd, 1984.

² Shih: *Historia e Shqipërisë*, II, Tiranë, 1984, f. 468-485.

përshkrimin, si dhe në precizitetin kronologjik të zhvillimit të ngjarjeve gjatë kryengritjes, kam bërë krahasime të të dhënave që hasen në faqet e gazetës "Borba", me të dhënat që u referohen burimeve historike dhe literaturës përkatëse që disponoj³.

Shkaqet për fillimin e kryengritjes

Kryengritja e përgjithshme shqiptare, edhe sipas gazetë "Borba", filloi nga mesi i muajit prill të vitit 1912⁴.

Që në fillim duhet të theksojmë se kërkesat e kryengritësve shqiptarë, marrë të tërësi, qëndronin në suaza të privilegjeve që pushteti osman paraprkishte ua kishte njohur malësorëve: "privilegje të atilla të njëjta, siç u janë dhënë malësorëve"⁵ katolikë, sipas marrëveshjes së 3 gushtit të vitit 1911 të nënshkruar në Podgoricë⁶. Sipas korrespondentit të përherëshëm të gazetës "Borba" nga Prizreni, me pseudonimin "Gllendo", fillimisht kërkesat e kryengritësve shqiptarë ishin: bartja e lirë e armëve; shërbimi ushtarak në trevat e veta; të mos ngrihen karrakolla xhandarmerike e ushtarake nëpër fshatra; të mos paguajnë tatime⁷, si dhe të mbyllen shkollat në gjuhën dhe alfabetin turk etj⁸. Mirëpo, një autor tjetër me pseudonimin "Orlowsky", në shkrimin e tij analitik të karakterit publicistik "Lëvizja më e re shqiptare", duke mos i injoruar edhe shkaqet

³ Shih për këtë: Sh. Rahimi, *Kryengritjet shqiptare në Kosovë më 1909-1912*, Enti i i Historisë së Kosovës - Zavod za istoriju Kosova, "Kosova-Kosovo", nr. 1, Prishtinë-Prishtina; M. Rizvanolli, *Zgjedhjet parlamentare në Dibër më 1912 dhe fillimi i qëndresës së armatosur antiosmane*, Universiteti i Prishtinës, "Buletin i Fakultetit Filozofik", XXI/1991, Prishtinë, 1993; *Dokumenti o spolnoj politici Kraljevine Srbije 1903-1914*, Knjiga V, Sveska 1; B. Hrabak, *Arbanaški ustanci 1912 Godine*, Narodni muzej u Vranju, "Vranjski glasnik", kw. XI, Vranje, 1975.

⁴ Shih: *Historia e Shqipërisë*, II, Tiranë, 1984, f. 469; *Dopis iz Skopja*, "Borba", Br. 14, Beograd, 21.04./4.05. 1912. (Gazeta "Borba" asokohe bënte njësimin e kohës sipas kalendarit të vjetër gregorian, i cili dallonte nga ky i sotmi për 13 ditë).

⁵ *Vreme arnauta; Zaplet u Albaniji*, "Borba", Br. 21, Beograd, 28.04./11.05.1912.

⁶ S. Skëndi, *Mendimi politik dhe veprimtaria kryengritëse shqiptare 1881-1912*, përkthyer prej Sejfi Protopapës, New York, 1958, f. 27.

⁷ *Pismo iz Prizrena* (Od našeg redovnog dopsisnika-30.04.1912), "Borba", Br.30, Beograd, 7./20.05.1912.

⁸ *Pobuna Arnauta* (Pobuna zauzima veçe razmere), "Borba", br. 31, Beograd, 8./21.05.1912.

që bazën e kishin në politikën e shtypjes dhe të dhunës së pushtetit xhonturk mbi shqiptarët, si dhe ndërhyrjen e faktorëve të jashtëm, si p.sh. atij austro-hungarez dhe italian, arsyet dhe motivet kryesore për kryengritjen shqiptare i sheh me bazë shumë më të thellë dhe më komplekse. Përkatësisht, ai shkaku kryesor për shpërthimin e kryengritjes e bazon në motivin dhe synimin e shqiptarëve për Autonominë e Shqipërisë, duke pohuar shprehimisht se: "Autonomia e Shqipërisë, do të thotë është qëllimi më i lartë dhe forcë e përhershme promotore, që i bënë të vendosur shqiptarët për trazira dhe kryengritje kaq të shpeshta"⁹.

Nga ana tjetër, siç njoftonte "Borba", Porta e Lartë motivet e kryengritjes shqiptare i vendoste në suaza të interesave personale të provokuesve të saj. Porta si provokues të kryengritjes shqiptare konsideronte Hasan Prishtinën dhe Zejnulla Zeglian (beun). Gjoja se këto dy persona, për interesat personale të tyre, i shtynë shqiptarët që t'i kundërshtonin reformat administrative dhe ekonomike osmane, siç ishin: ndërtimi i rrugëve, shkollave, stacioneve telegrafike dhe karakollave xhandarmerike, për zbatimin e të cilave, në vilajetet e Shkodrës dhe të Kosovës, ishte obliguar "Komisioni Shtetëror i Reformave"¹⁰. Por, siç konstatonte edhe "Borba", e vërteta ishte krejt tjetër. Shqiptarët e trevave të Gjakovës, Prishtinës, Vushtrrisë dhe të Malësisë kundërshtonin këto reforma, sepse ato i konsideronin si "masa të përkohshme ushtarake, ndaj dhe situata atje ishte kritike"¹¹.

Ndërkaq, kriza parlamentare, pas shpërndarjes së parlamentit osman më 18 janar 1912, ishte ajo që e përshpejtoi procesin e shpërthimit të kryengritjes shqiptare. Kriza parlamentare ngriti tensionin në marrëdhëniet midis partive politike osmane: Komitetit "Bashkim e Përparim" (Ittihad ve Terakki) apo Komiteti xhonturk dhe Partisë "Liri e Marrëveshje" (Hyrijet ve Ittilaf). Ndërkaq, kjo situatë u reflektua edhe në marrëdhëniet e gjithëmbarshme politike e shoqërore në shtetin osman. Gjatë zgjedhjeve të reja parlamentare, pushteti xhonturk (i Komitetit "Bashkim e Përparim") bënte shkelje flagrante të sistemit zgjedhor. Xhonturqit insistonin që, nëpërmjet falsifikimit të procesit të votimit, të

⁹ *Najnovi Arnautski pokret*, "Borba", Br. 28, Beograd, 5/18.05.1912.

¹⁰ *Pobuna Arnauta*, "Borba", Br. 35, Beograd, 12/25,13/26 i 14/27.05.1912.

¹¹ *Po aty*, Br. 20, Beograd, 27.04/10.05.1912.

siguronin me forcë fitoren e kandidatëve të vet¹². Ndaj dhe paria opozitare shqiptare "nga qyteti", për të kundërshtuar "jomoralin e shprehur veçanërisht gjatë zgjedhjeve parlamentare" të pushtetit xhonturk, e nxitën këtë kryengritje shqiptare¹³.

Nga sa u tha, shkaqet dhe motivet për shpërthimin e kryengritjes shqiptare, edhe sipas gazetës "Borba", ishin komplekse, që do të thotë, ata ishin të karakterit: social, kulturor, politik dhe kombëtar.

Fillimi, përmasat dhe rrjedha e kryengritjes në fazën e parë

Sipas gazetës "Borba", çeta të shumta kryengritëse shqiptare ishin formuar që në muajt e parë të vitit 1912, dhe se ata "gjatë gjithë dimrit kanë sunduar në Dukagjin". Ndër udhëheqësit e çetave, që përmenden nga kjo gazetë, ishin edhe Zefi i Vogël, Gjell Luka dhe Pjetër Ramoi (Celi!). Çetat shqiptare gjatë dimrit bënë edhe armatosjen e popullatës civile. Ndërkaq, Mahmut Zajmi, pari nga Peja, i cili që në dimër kishte kaluar në çetë, ishte njëri nga ata që dallohej në armatosjen dhe drejtimin e çetave në këtë pjesë të Shqipërisë, apo të Arnautllukut, si në fazën përgatitore përpara shpërthimit ashtu edhe gjatë shpërthimit dhe zhvillimit të kryengritjes. Këto çeta, të nxitura nga "opozita në qytete", me aksionet e tyre guerile e kanë çuar përpara këtë lëvizje të armatosur shqiptare, vlerësohej në gazetën "Borba"¹⁴. Kështu, nga fundi i prillit dhe fillimi i majit 1912, shqiptarët dhe grupe të "itilavxhijve", të pakënaqur nga zhvillimi i procesit të zgjedhjeve, përgatisnin me të madhe trazira, ndaj dhe për çdo ditë shtoheshin numri i çetave shqiptare.

Për këtë arsye edhe autoritetet osmane nga ana e tyre ndërmorën masa konkrete kundër çetave shqiptare. Më 27 (ose 28) prill 1912, një batalion me ushtarë osman kishte shkuar nga Shkupi në Ferizaj, për të ndjekur çetat shqiptare që ishin paraqitur në rrethinat e Ferizajt¹⁵.

¹² *Pobuna Arnauta* (Pobuna zauzima veçe razmere), "Borba", Br. 31, Beograd, 8/21.05.1912.

¹³ *Pismo iz Prizrena* (Od našeg redovnog dopisnika-30.04/13.05.1912), "Borba", Br.30, Beograd, 7/20.05.1912.

¹⁴ *Po aty* (Od našeg redovnog dopisnika-30.04.1912), "Borba" Br.30, Beograd, 7/20.05.1912; *Vesti iz Stare Srbije* (Pismo iz Prizrena), "Borba", Br. 35, Beograd, 12/25,13/26 i 14/27.05.1912.

¹⁵ *Dopis iz Skopja*, "Borba", Br. 14, Beograd, 21.04/4.05. 1912.

Sipas gazetës "Borba", dy incidente ishin shkak të qeveria osmane të ndërmarrë aksione masive ushtarake kundër çetave shqiptare: i pari, ishte sulmi i shqiptarëve mbi "stallën e artilerisë" në Guci; kurse i dyti, ishte rrëmbimi i djalit të Hysein Damanës (Daljanës!) nga ana e çetave në kazanë e Pejës.

Përkatësisht, në fillim të majit të vitit 1912 një çetë shqiptare sulmoi "stallën artilerike" në Guci. Në ndjekje të sulmuesve u vranë tre ushtarë osman dhe tre të tjerë u plagosën, gjithashtu edhe nga pala shqiptare mbetën më shumë veta të vrarë. Kurse, rrëmbimin e të birit të Husein Daljanit e bëri Qazim Leka me çetën e tij, për të ngacmuar (ndezur) konfliktin midis shqiptarëve dhe pushtetit. Për të vënë gjendjen nën kontroll, autoritetet osmane filluan të grumbullonin forcat ushtarake në Ferizaj; dërguan një batalion osman të këmbësorisë dhe një bateri kodrinore, prej nga këto forca duhej të shkonin në Pejë dhe rrethinë me që, siç thuhej, se gjendja atje vlonte. Kështu, menjëherë nga Ferizaj u dërguan të ndjekin Qazim Lekën dhe çetën e tij dy batalione të këmbësorisë dhe një bateri kodrinore.

Në rrethana të tilla, sipas gazetës "Borba", situata së pari eskaloj në kazanë e Pejës. Më 5 maj, një pjesë e shqiptarëve të pakënaqur nga pushteti osman morën kodrat rreth fshatit Istog, midis Pejës dhe Mitrovicës¹⁶. Në eskalimin e situatës, në kazanë e Pejës, ndikoi edhe arratisja në mal e Hasan Prishtinës me çetën prej rreth 300 vetash, i cili, siç flitej, e nxiste popullatën e atjeshme në kryengritje të armatosur kundër pushtetit osman¹⁷. Të theksojmë se një konstatim i këtillë në gazetën "Borba", për atë se Hasan Prishtia ishte organizatori dhe udhëheqësi kryesor i kryengritjes në Kosovë, korrespondon edhe me rrëfimin memorial të vetë Hasan Prishtinës në: "Një shkurtim kujtimesh mbi kryengritjen shqiptare të vitit 1912"¹⁸.

¹⁶ *Vreme arnauta*, "Borba", Br. 20, Beograd, 27.04/10.05.1912; *Pobuna Arnauta*, "Borba", Br. 27, Beograd, 4/17.05.1912.

¹⁷ *Pobuna Arnauta*, "Borba", Br. 24, Beograd, 1/14.05.1912; *Po aty* (Današnji kaos u Turskoj), "Borba", Br., 26, Beograd, 3/16.05.1912; *Pismo iz Prizrena* (Od našeg redovnog dopsisnika-30.04/13.05.1912), "Borba", Br.30, Beograd, 7/20.05.1912.

¹⁸ Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, *Hasan Prishtina, (Përmbledhje dokumentesh), 1908-1934*, përgatitur nga Kujtim Nuro dhe Nezir Bata, Tiranë, 1983, f. 78-79.

Por, kur "ulemaja" dhe "qytetarët autoritativ" të angazhuar në misionin që të bindin shqiptarët të heqin dorë nga kryengritja, nuk jepte rezultatet e pritura. Si kundërpërgjigje, pushteti në Pejë dhe rrethinë kishte shpallur gjendje shtetrrethimi dhe më 7 maj kishte ngritur "Gjyqin ushtarak". Por tani në trevat e Pejës dhe të Gjakovës, kryengritja e armatosur e çetave shqiptare e formës guerile, që kishte filluar nga mesi i muajit prill të vitit 1912 në fillim të majit të vitit 1912, mori dimensione të reja, duke u ngritur në kryengritje masive popullore e formës së luftës frontale me trupat osmane. Trupat osmane që po përqendroheshin vazhdimisht në rrethinën e Pejës, fillimisht kishin për detyrë të rrethonin kryengritësit në Istog, duke qenë të udhëzuar që në atë çast mundësisht t'iu shmangen luftimeve me kryengritësit, përderisa të arrinin përfundime të reja osmane. Megjithatë, njoftohet se më 9-10 maj zhvilloheshin luftime të ashpra në Istog, midis kryengritësve dhe trupave osmane¹⁹. Me ç'rast qe zhdukur një batalion i tërë ushtarësh osman në afërsi të Istogut²⁰, por dhe shqiptarët patën humbje të mëdha. Përderisa në fillim të majit 1912 kryengritja fillimisht u shtri në kazatë e Pejës dhe të Gucisë, në vetë qytetin e Pejës ende mbretëronte qetësia²¹. Në dekadën e parë të muajit maj të vitit 1912, eskalimi i kryengritjes e vuri mytesarifin e Pejës përpara një situatë shumë të rëndë²².

Siç u tha, tanimë kryengritja ishte zgjeruar edhe në nahijen e Gjakovës. Pra, as këtu nuk pati sukses misioni i ulemave për qetësimin e shqiptarëve. Kryengritësit e Gjakovës, rreth 2000 veta, gjysma nga të cilët ishin përqendruar në kodrat rreth Gjakovës, refuzuan "të gjitha përpjekjet e pushtetit për paqe", nëpërmjet ulemave. Kryengritësit kërkuan nga autoritetet shtetërore që menjëherë t'iu rikthehen armët që iu morën gjatë ekspeditës së çarmatosjes nga ana e Xhavit Pashës. Ndërkaq, autoritetet osmane jo vetëm që nuk pranonin kërkesat e kryengritësve, por kërcënuan se nëse kryengritësit nuk shpërndaheshin, do të

¹⁹ *Vrewe arnauta*, "Borba", Br. 21, Beograd, 28.04/11.05.1912; *Pobuna Arnauta*, Borba", Br. 24, Beograd, 1/14.05.1912.

²⁰ *Pismo iz Prizrena* (od redovnog dopisnika-30.04/13.05.1912.), Br. 30, Beograd, 7/20.05.1912.

²¹ *Vreme arnauta dhe Ratni sud u Peqi*, "Borba", Br. 21, Beograd, 28.04/11.05.1912.

²² *Pismo iz Prizrena* (od našeg redovnoga dopisnika 30.04/13), "Borba", Br. 30, Beograd, 7/20.05.1912.

sulmoheshin nga ushtria²³. Përveçse në Pejë, tani gjyqi ushtarak funksiononte edhe në Gjakovë²⁴. Për të shtypur kryengritjen autoritetet osmane kishin dërguar nga Shkupi dy bateri topash për në Gjakovë. Meqë kryengritësit e Gjakovës refuzuan që të shpërndahen, rreth 9-10 majit të vitit 1912, njoftohej se zhvilloheshin luftime edhe në nahijen e Gjakovës²⁵.

Nga ana tjetër, rreth 11 majit, qarqet zyrtare partiake xhonturke në nahijen e Gjakovës, përkundër faktit se këtu kishte shpërthyer konflikti i armatosur, përpara opinionit, për qëllime politike, mohonin se po bëhet grumbullimi i kryengritësve shqiptarëve rreth Gjakovës dhe, sipas tyre kryengritje ka vetëm në kazatë e Pejës dhe të Gucisë²⁶. Gjithashtu, edhe komandanti i Korpusit të shtatë (të Shkupit), Fadil Pasha, i cili më 10 maj shkoi nga Shkupi në Mitrovicë me: dy skuadra të kalorësisë; njësitin e mitralozëve dhe aradhën spitalore²⁷, me të arritur në Mitrovicë, duke u mbështetur në raportet zyrtare, ai dërgoi nga atje një raport ku pohonte se, përveç se në raste të veçanta, në Gjakovë dhe në Pejë mbretëronte rendi dhe se "gjyqet ushtarake" veç më vepronin këtu²⁸. Por, në fakt autoritetet e larta osmane ishin plotësisht në dijeni mbi seriozitetin e kryengritjes shqiptare. Më 10 maj në një këshillim të disa ministrave osman u shqyrtuan masat që duhej të ndërmerreshin, me qëllim që sa më shpejtë të shtypet kryengritja shqiptare gjithsesi me forcën e ushtrisë, ndaj dhe ishte marrë vendimi që menjëherë, të nesërmen, kundër kryengritësve të dërgoheshin tre batalione osmane²⁹. Kështu që me një intensitet të shtuar vazhdonte dislokimi i trupave osmane në trevat kryengritëse në Shqipëri.

Autoritetet përkatëse osmane kishin urdhëruar që një batalion i këmbësisë dhe një bateri malore të nisej nga Ferizaj për tu dislokuar në Pejë dhe rrethinë³⁰. Ndërkohë, tre batalione të tjera të këmbësisë kishin shkuar në Mitrovicë. Ndërkaq, rreth muajit 11 maj, një batalion e gjysmë këmbësorie dhe një bateri kodrinore, kishin arritur në Istog, ku u

²³ *Pobuna Arnauta*, "Borba", Br. 24, Beograd, 1/14.05.1912.

²⁴ *Po aty* (Ratni sudovi u Gjakovici i Peqi), "Borba", Br. 27, Beograd, 4/17.05.1912.

²⁵ *Borba s Arnautima*, "Borba", Br. 20, Beograd, 27.04/10.05.1912.

²⁶ *Vreme Arnauta*, "Borba", Br. 21, Beograd, 28.04/11.05.1912.

²⁷ *Pobuna Arnauta*, "Borba", Br. 25, Beograd, 2/15.05.1912.

²⁸ *Po aty*, Br. 27, Beograd, 4/17.05.1912.

²⁹ *Vreme arnauta*, "Borba", Br. 21, Beograd, 28.04/11.05.1912.

³⁰ *Po aty*, Br. 20, Beograd, 27.04/10.05.1912.

bashkuan me tre batalione që kishin ardhur nga Peja. Ardha e artilerisë osmane i detyroi kryengritësit shqiptarë të Istogut të tërhiqen nëpër male. Trupat osmane i ndiqnin kryengritësit dhe gjatë gjithë natës u zhvilluan luftime.

Gjithashtu, edhe në trevën e Gjakovës atë ditë zhvilloheshin luftime, midis kryengritësve dhe ushtrisë osmane³¹. Njoftohet se kajmekami i Gjakovës ishte plagosur³².

Ndërkohë, rreth datës 10 maj 1912, trupat osmane ngritën llogoren e tyre në kodrën "Jerinja", në afërsi të Pejës, përballë manastirit të Patrikanës. Mirëpo, këto trupa osmane u sulmuan nga kryengritësit e Rugovës nën udhëheqjen e Haxhi Mustafës dhe u detyruan të dislokohen në kazemat e Pejës. Gjithashtu, nga mesi i muajit maj, kryengritësit e zonës së Istogut, nën udhëheqjen e bajraktarit të fisit Gash, Xhemë Rexha, nga fshati Svërçkë, ia dolën që në fshatin Istog të rrethonin dy batalione ushtarësh osman. Këtyre batalioneve osmane të rrethuara u shkoi në ndihmë nga Mitrovica një batalion me 4 topa, por në fshatin Rudnik pati një përpjekje të rreptë me kryengritësit. Luftimet në Rudnik e ngadalësuan lëvizjen e këtij batalioni, i cili mezi arriti deri në fshatin Gjurakoc. Batalioni nuk mundi të bashkohej me dy batalionet e rrethuara në Istog, por përkundrazi, edhe ky batalion u rrethua në Gjurakoc nga kryengritësit shqiptarë. Tani ky batalion, edhe pas 20 majit, qëndronte në këtë fshat, i izoluar nga shërbimet e intendanturës ushtarake osmane, ndaj dhe me të mira materiale për nevojat e veta furnizohej nga fshatarët³³.

"Borba" njoftonte se asokohe edhe në vetë qytetin e Pejës kishte një konflikt të armatosur midis shqiptarëve dhe ushtrisë osmane. Kështu, më 19 maj, me rastin e hedhjes së themeleve të shkollës idadie (gjimnazit) në Pejë erdhi dhe përleshja midis shqiptarëve dhe ushtrisë, me ç'rast u vranë 20 ushtarë osman. Por nga Stambolli, mytesarifit të Pejës iu urdhërua që ushtria të mos i sulmojë shqiptarët, një urdhër i tillë shpjegohej me mungesën e efektivave të mjaftueshme ushtarake. Ndërkohë, për të fituar kohë për përforcime të reja ushtarake, përderisa rreth Pejës kishte mbi 3 000 kryengritës të armatosur, autoritetet iu premtuan shqiptarëve se së

³¹ *Pobuna Arnauta*, "Borba", Br. 25, Beograd, 2/15.05.1912.

³² *Pismo iz Prizrena* (Od našeg redovnog dopisnika-30.04/13.05.1912), "Borba", Br. 30, Beograd, 7/20.05.1912

³³ *Pobuna Arnauta* (Pismo iz Prizrena), "Borba", Br.35, Beograd, 12/25,13/26 i 14/27.05.1912.

shpejti do të vijë komisioni për të përmbushur kërkesat e tyre. Pas kësaj duket se tani u arrit armëpushimi³⁴.

Pra, gjatë tri javëve të para të muajit maj 1912, ishin ngritur në kryengritje masive të armatosura shqiptarët e trevave të Pejës e të Gjakovës dhe malësitë e tyre; Hasi, Malësia e Sipërme dhe e Poshtme, Podguri, Reka dhe Rugova, përkatësisht fiset Mërturi, Nikaj, Krasniqja, Gashi, Berisha etj. Duhet theksuar se në kryengritje u përfshi popullata e këtyre trevave pa dallim feje; mysliman e katolik. Numri i kryengritësve nuk dihet, jepet një numër që konsiderohet si i fryrë rreth 30 000 veta, por gjithsesi numri i kryengritësve ishte i madh. Lidhur me masivitetin e kryengritjes, korrespondenti i përhershëm i "Borbës" nga Prizreni vlerëson: "Pa mëdyshje, janë shumë, pasi që kanë marrë guximin që ushtrinë ta presin në fushë të hapur dhe të ndeshen me të"³⁵. Ai, në një shkrim tjetër, vlerëson se kryengritësit ishin të armatosur dobët, iu mungonin armët, një pjesë e kryengritësve, në mungesë të armëve, ishin angazhuar në kryengritje me sëpata në dorë. Mahmud Zajmi ishte më së tepërmi i angazhuar me çështjen e furnizimit me armatime, ai armatoste grupe të njerëzve dhe ua dërgonte kryengritësve në ndihmë³⁶. Përkundër faktit se kryengritësve iu mungonte arsenali i nevojshëm luftarak, ata nuk hezitonin të përballëshin në luftë frontale me batalionet osmane të organizuara dhe të armatosura sipas standardeve ushtarake. Kështu, po sipas "Borbës", në gjysmën e parë të muajit maj të vitit 1912, luftime frontale u zhvilluan përgjatë vijës së frontit: Prizren-Gjakovë-Pejë-Mitrovicë. Ndërkaq, betejat më të mëdha midis kryengritësve dhe ushtrisë osmane për gjatë kësaj vije të frontit u zhvilluan te Ura e Shenjtë, midis Prizrenit dhe Gjakovës, pastaj diku midis Gjakovës dhe Pejës, si dhe në fshatin Istog, midis Pejës dhe Mitrovicës. Ushtria osmane e angazhuar në këtë front të luftës me kolonat kryengritëse shqiptare, me që ishte e pajisur dhe me topa, për gjashtë ditë me radhë goditi me artileri të rëndë pozitat luftarake të kolonave kryengritëse shqiptare. Mirëpo, efektivat e shumta osmane në njerëz dhe në teknikë luftarake nuk ia

³⁴ *Pobuna Arnauta*, "Borba", Br. 30, Beograd, 7/20.05.1912.

³⁵ *Pismo iz Prizrena* (Od našeg redovnoga dopisnika), "Borba", Br. 30, Beograd, 7/20.05.1912; *Arbanskog pokreta*, "Borba", Br. 36, Beograd, 15/28.05.1912.

³⁶ *Vesti iz Stare Srbije* (Pismo iz Prizrena), "Borba", Br. 35, Beograd, 12/25,13/26 i 14/27.05.1912.

dolën të shtypin kryengritjen shqiptare në këtë fazë, sepse morali luftarak i kryengritësve motivohej nga ideali i tyre për liri.

Është me interes se, sipas "Borbës", kryengritësit shqiptarë e ftuan edhe popullatën serbe të kësaj ane që t'iu bashkohen kryengritjes shqiptare kundër osmane, por serbët e refuzuan këtë ftesë³⁷.

Krahas trevave të Pejës dhe të Gjakovës, kryengritja masive shqiptare shpërtheu edhe në Dibër të Vogël dhe në Lumë. Kështu, që në dhjetëditëshin e parë të majit, gjithnjë e më shumë po merrte përmasa kryengritja në Dibër të Vogël. "Borba" njofton se në Malësinë e Dibrës, rreth 14 majit, trupat osmane të Batalionit të dytë të Regjimentit të 49-të në luftë me kryengritësit shqiptarë pësuan humbje të mëdha; rreth 100 ushtarë të vrarë³⁸. Kurse, rreth 17 maj në fshatrat Reç e Dardhë të Malësisë së Dibrës pati një përpyekje tjetër midis çetave shqiptare dhe trupave osmane, kryengritësve u erdhën në ndihmë edhe fshatarët e fshatrave përreth dhe, përpara mësymjes së fuqive kryengritëse, trupat osmane ishin të detyruara të zmbropseshin³⁹.

Gazeta "Borba" njoftonte se, sipas shumë burimeve, nga mesi i majit të vitit 1912 kryengritja jo vetëm që ishte shtrirë në Malësinë e Dibrës, por situata vlonte edhe në Mirditë dhe në gjithë Vilajetin e Shkodrës. Ndërkaq shqiptarët e kazasë së Prizrenit ishin të qetë. Ata të Podrimës as që mund të ngriheshin në kryengritje, sepse ushtria osmane i kishte shtrënguar fort. Vetëm Luma kishte mundësi të ngrihej në kryengritje, por duket se paria e Lumës, veçanërisht Ismail Spahiu, sipas korrespondentit të "Borbës" nga Prizreni, asokohe ishte përfituar nga pushteti xhonturk me shuma të mëdha. Mirëpo, sipas lajmeve që vinin nga Prizreni, rreth 18 majit, e gjithë Luma gjendej në kryengritje. Lumjanët i kishin shpartalluar dhe përzënë karakollet ushtarake, dhe kërcënonin dhe vetë Prizrenin.

Pra, krahas luftës frontale të kolonave kryengritëse në Dukagjin, përkatësisht në trevat e Pejës dhe të Gjakovës, si dhe në krahinat e Dibrës dhe të Lumës, në trevat e tjera përreth, çetat kryengritëse shqiptare asokohe ndërmorën një sërë aksionesh guerile kundër trupave dhe

³⁷ *Pismo iz Prizrena* (Od našeg redovnog dopsisnika-30.04.1912), "Borba", Br.30, Beograd, 7/20.05.1912; *Vesti iz Stare Srbije* (Pismo iz Prizrena), "Borba", Br. 35, Beograd, 12/25,13/26 i 14/27.05.1912.

³⁸ *Pobuna Arnauta*, "Borba", Br. 25, Beograd, 2/15.05.1912

³⁹ *Sukob vojske sa Arnautima*, "Borba", Beograd, Br. 28, Beograd, 5/18.05.1912.

institucioneve administrative osmane. Këto aksione të armatosura, çetat shqiptare në radhë të parë i ndërmerrnin me qëllim që të mbanin të ngujuar trupat osmane në ato zona, dhe kështu të pengonin angazhimin e tyre në luftën kundër kolonave kryengritëse në trevat e Pejës dhe të Gjakovës. Kështu, kryengritja vazhdimisht merrte karakter mbarëpopullor, duke u shtrirë në forma të ndryshme (guerile dhe frontale) gati në gjithë Shqipërinë, Arnautllëkun. Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme Osmane, Hasan Prishtina dhe Jahiu nga Prizreni, do të punojnë së bashku me Isa Boletinin për zgjerimin e Kryengritjes. Ata pasi e ngritën në kryengritje popullsinë e Vushtrisë, shkuan në Pejë dhe Gjakovë. Pra, Hasan Prishtina ishte organizatori dhe drejtuesi kryesor i kryengritjes në trevën e Vushtrisë⁴⁰. Kështu, luftime midis çetave shqiptare dhe ushtrisë osmane zhvilloheshin edhe në trevat e Vushtrisë dhe të Llapit, veçanërisht lëvizja kryengritëse ishte e fuqishme në Vushtrri. Rreth 17 majit të vitit 1912 u zhvilluan luftime midis çetave dhe ushtrisë në kazanë e Vushtrisë, në Llab, ku mbeti i vrarë një udhëheqës i çetës⁴¹. Rreth 19 majit kryengritësit shqiptarë sulmuan depon e armëve në Vushtrri, por pas kërcënimit se kundër tyre do të vihet në veprim artileria (topat), kryengritësit u zbrapsën nga grabitja e depos. Kryengritja ishte shtrirë edhe në Prishtinë, shqiptarët këtu ngritën krye kundër shkeljes së legjislacionit zgjedhor-elektoral, por dhe kërkonin, "si gjithkund", mbylljen e shkollave në gjuhën dhe alfabetin turk⁴².

Kështu, krahas vilajeteve të Kosovës dhe të Shkodrës, në dekadën e dytë të muajit maj të vitit 1912 kryengritja shqiptare zgjerohej me shpejtësi të madhe edhe në vilajetet e Manastirit dhe të Janinës, ndaj dhe Perandoria Osmane ishte përpara mundësisë së kryengritjes serioze të përgjithshme shqiptare, konstaton "Borba"⁴³. Nga gjysma e dytë e majit, në vilajetin e Janinës, ish deputeti Mufid zhvillonte "aktivitetin e vet më të madh"⁴⁴. Rreth 20 majit njoftohet për një sulm të një çete shqiptare në

⁴⁰ *Pobuna Arnauta dhe Pismo iz Prizren* (Od našeg redovnoga dopisnika), "Borba", Br. 30, Beograd, 7/20.05.1912.

⁴¹ *Sukob vojske sa Arnautima* (Arnauti se rasturaju u ~ete, i vrje gerilsko ratovane), "Borba", Br. 28, Beograd, 5/18.05.1912.

⁴² *Pobuna Arnauta* (Pobuna zauzima veje razmere), "Borba", Br. 31, Beograd, 8/21.05.1912.

⁴³ *Pobuna Arnauta* (Današnji haos u Turskoj), "Borba", Br. 26, Beograd, 3/18.05.1912.

⁴⁴ *Pobuna Arnauta*, "Borba", Br. 35, Beograd, 12/25,13/26 i 14/27.05.1912.

rrethinën e Janinës, mbi Hafiz Efendiun dhe rojën (eskortën) e tij xhandarmerike⁴⁵.

Pra, që në fazën e parë të saj, kryengritja shqiptare apo atmosfera e kryengritjes ndjehej në të njëjtën kohë në forma të ndryshme, si në Shqipërinë e Veriut, ku fillimisht shpërtheu kryengritja, ashtu edhe në Shqipërinë e Jugut, përkatësisht "deri në kufijtë më të skajshëm jugor" të Shqipërisë, siç vlerësonte gazeta "Borba"⁴⁶.

Armëpushimi, përgatitjet për fazë të re të luftimeve

Pasi që qeveria xhonturke me forcën e armëve nuk mund të pacifikonte Shqipërinë, Këshilli i Ministrave, në Stamboll, nxori vendimin që ministri i Punëve të Brendshme, Haxhi Adil Beu, i cili ndodhej në Selanik, të shkon në Shkup për arritjen e një marrëveshje me shqiptarët. Sipas këtij vendimi, nga mesi i majit, ministri kishte udhëtuar nga Selaniku për në Shkup, me autorizim që të zhvillojë negociata me shqiptarët dhe të gjejë e të propozojë mjete për qetësimin e tyre.

Në këtë kuadër, në Pejë qe formuar një Komision i përbërë nga hoxhallarët dhe ulematë, për të bindur kryengritësit të heqin dorë nga kryengritja. Apo siç thuhej: Komisioni kishte për detyrë të zhvillojë hetime për të konstatuar nëse kërkesat e shqiptarëve janë në harmoni me Sheriatin. Nëse vlerësohet se kërkesat e tyre nuk janë në harmoni me Sheriatin, atëherë komisioni duhej t'iu shpjegojë shqiptarëve se për kërkesa të tilla nuk mund të ketë negociata, kurse nëse kërkesat janë në harmoni, të vazhdojnë negociatat. Kjo nga ana e pushtetit osman bëhej krejt për qëllime taktike, për të fituar kohë derisa ushtria osmane shtesë të arrinte në Kosovë e më gjerë në Shqipëri. Mirëpo, shqiptarët ministrit "i kishin shtruar të tilla kërkesash që ishin të pamundura të plotësoheshin", konstatonte "Borba"⁴⁷.

Megjithatë, më 14 maj qe arritur armëpushimi për disa ditë, midis ushtrisë osmane dhe kryengritësve shqiptarë në Gjakovë. Propozimi për armëpushim erdhi nga Shkupi dhe kryengritësit e pranuan, sepse Shkupi premtoi që do të plotësojë të gjitha kërkesat e tyre, si p.sh. të gjithë shqiptarëve t'u kthehen armët; që rekrutët shqiptarë shërbimin ushtarak ta kryejnë jo larg Shkupit; tatimet për mallrat të mos rriten, por të mbesin si

⁴⁵ *Po aty*, Br. 30, Beograd, 7/20.05.1912.

⁴⁶ *Arbanskog pokreta*, "Borba", Br. 36, Beograd, 15/28.05.1912.

⁴⁷ *Pobuna Arnauta*, "Borba", Br. 25, Beograd, 2.05.1912; *Po aty*, Br. 33, Beograd, 10/23.05.1912.

deri më tani (2 grosh) etj. Kjo marrëveshje, siç thuhet, u arrit fal Riza bej Kryeziut, nga Gjakova. Pas marrëveshjes për armëpushim, forcat kundërshtarë qëndrojnë në llogore përgjatë vijës së frontit, në ato pozita ku u ndodhën përpara marrëveshjes. Kështu, ushtria osmane ndodhet në Gjakovë, të cilën arriti ta marrë pas fitores në betejën tek "Ura e Shenjtë", midis Gjakovës dhe Prizrenit, ku ishin zhvilluar më parë luftime dhe trupat osmane arritën ta marrin atë me luftë, kurse llogorja e shqiptarëve ishte në afërsi të trupave osmane; në një kodrinë mbi qytetin e Gjakovës. Ndaj dhe aktualisht gjendja në Gjakovë ishte e qetë, shqiptarët prisnin realizimin e premtimeve⁴⁸.

Gjithashtu, rreth 18-19 majit, në kohën kur përreth Istogut kishte të dislokuar rreth gjashtë batalione ushtarake osmane, diku në afërsi të Istogut zhvilloheshin negociata midis përfaqësuesve të ushtrisë osmane dhe të përfaqësuesve të kryengritësve të Pejës, për të arritur një armëpushim. Në këto negociata, shqiptarët deklarorin se nuk do ta nxisnin ushtrinë, nëse ajo nuk i sulmon ata. Megjithatë, kryengritësit shqiptarë edhe më tej nuk u shpërndanë, përderisa nuk do t'iu ktheheshin armët dhe nuk realizoheshin të gjitha premtimet e tjera⁴⁹. Por, "burimet autentike" njoftorin se kryengritësit shqiptarë nga trevat e Pejës dhe të Gjakovës, rreth 18 majit, ishin shpërndarë⁵⁰. Sidoqoftë, pas armëpushimit gjendja në Pejë dhe në Mitrovicë po përmirësohej dukshëm, apo ndoshta autoritetet osmane dëshironin ta paraqisnin gjendjen si të tillë, ndaj dhe përsëri filluan punimet për ndërtimin e rrugëve në afërsi të Pejës, nën mbrojtjen e rojeve nga Peja dhe Mitrovica⁵¹.

Gjithashtu, pas armëpushimit me afat dhjetëditor, të arritur midis ushtrisë osmane dhe kryengritësve të trevave të Gjakovës dhe të Pejës, qarqet zyrtare nga Mitrovica njoftorin se kryengritja në Shqipërinë Veriore konsiderohet e përfunduar. Në këtë kuadër, edhe pjesës më të madhe të trupave osmane që ishin nisur për në Kosovë iu urdhërua të ndalonin në Ferizaj⁵². Kështu, falë armëpushimit dhjetëditor të garantuar me besën shqiptare, në Kosovë tani (22 maj) nuk kishte më luftime. Si duket ky armëpushim ishte i nevojshëm për të dy palët ndërluftuese, për

⁴⁸ *Vesti iz Stare Sebije* (Pismo iz Prizrena, 7.05.1912), "Borba", Br. 35, Beograd, 12/25,13/26 i 14/27.05.1912.

⁴⁹ *Pobuna Arnauta*, "Borba", Br. 33, Beograd, 10/23.05.1912.

⁵⁰ *Po aty*, Br. 30, Beograd, 7/20.05.1912.

⁵¹ *Po aty*, Br. 31, 8/21.05.1912.

⁵² *Po aty*, Br. 27, Beograd, 4/17.05.1912.

të grumbulluar ushtarë dhe material luftarak. Duhet theksuar se morali luftarak i trupave osmane kishte rënë shumë, për këtë flet rasti i 500 ushtarëve që iu dorëzuan kryengritësve në Istog. Ky, siç duket, ishte edhe një faktor tjetër që i detyroi autoritetet osmane për armëpushim⁵³.

Megjithatë, me armëpushimin nuk u eliminuan shkaqet e konfliktit, sepse armëpushimi për momentin ishte imperativ për të dy palët, me qëllim të konsolidimit të radhëve ushtarake për fazën tjetër të luftës. Njëherazi, "Borba" konstaton, se tani në dekadën e tretë të muajit maj, shqiptarët e ndërruan taktikën e luftës, do të thotë se nga lufta frontale ata u orientuan në luftën guerile të çetave, ndaj dhe shtypja e kryengritjes shqiptare tani ishte vështirësuar mjaft për pushtetin⁵⁴. Gjë që edhe pas arritjes së armëpushimit, luftimet sporadike nuk u ndërprejnë plotësisht. Më 21 maj 1912 u bë një sulm i armatosur i shqiptarëve ndaj anëtarit të Gjyqit ushtarak, Fevzi beut, në rrugën nga Peja për në Mitrovicë. Pas sulmit, edhe pse Fevziu shoqërohej nga roja (eskorta) prej 40 vetash, ai u detyrua të kthehej mbrapsht në Pejë⁵⁵. Pra, situata në trevat e Pejës dhe të Gjakovës vazhdon, në mënyrë permanente, të jetë e tendosur edhe pas 22 majit. Hasan Prishtina dhe Nexhib Draga, pohon gazeta "Borba", kishin shkuar në Malësi për të kërkuar nga krerët e atjeshëm t'iu jepnin ndihmë për konfliktin që do të pasojë⁵⁶. Me këtë rast, duhet patur parasysh se ndërkohë, 21-25 maj 1912, zhvillonte punimet Kuvendi i Junikut⁵⁷. "Borba" njofton se edhe rreth 24-25 majit u zhvilluan luftime midis kryengritësve dhe trupave osmane të Istogut, ku u vranë 4 ushtarë dhe 2 kryengritës, si dhe në fshatin Klitë në rrethinën e Mitrovicës, ku kryengritësit sulmuan trupat osmane, me ç'rast mbetën të vrarë 6 ushtarë osman⁵⁸. Gjithashtu, në atë kohë, edhe Isa Boletini bënte përpjekje që të ngrinte në kryengritje Jeni Pazarin. Ai kishte kërcënuar të gjitha karakollat xhandarmerike osmane në rrethinat e Jeni Pazarit dhe të Mitrovicës që të zhvendosen nga këtu, se në të kundërtën të gjithë

⁵³ *Arbanskog pokreta*, "Borba", Br. 36, Beograd, 15/28.05.1912.

⁵⁴ *Sukob vojske sa Arnautima*, "Borba", Br. 28, Beograd, 5/18.05.1912.

⁵⁵ *Pobuna Arnauta*, "Borba". Br. 33, Beograd, 10/23.05.1912.

⁵⁶ *Po aty*, "Borba", Br. 34, Beograd, 11/24.05.1912.

⁵⁷ Shukri Rahimi, *vep. e cit.*, Enti i Historisë së Kosovës- Zavod za istoriju Kosova, *Kryengritjet shqiptare në Kosovë më 1909-1912*, "Kosova-Kosovo", nr. 1, Prishtinë-Prishtina.

⁵⁸ *Pobuna Arnauta*, "Borba", Br. 35, Beograd, 12/25,13/26 i 14.05.1912.

xhandarët do ti vrasë. Si kundërpërgjigje, pushti atje kishte dërguar ekspeditë ndjekje kundër tij⁵⁹.

Ndërkaq, edhe qeveria xhonturke vazhdonte me përqendrimin e trupave osmane nga Anadollia në Shqipëri. Më 19 maj nga Stambolli u nisën për në Ferizaj tre regjimente ushtarake dhe një batalion gjuetës⁶⁰. Më 21 dhe gjatë natës së 21/22 maj nëpër Selanik kaluan 7 "trena të mëdha" të mbushur me ushtarë (një divizion i tërë), që ishin përcjellë nga Stambolli për në Shkup dhe më tej në veri⁶¹. Gjithashtu, më 23 maj në Ferizaj kishte arritur edhe ministri osman i Punëve të Brendshme, Haxhi Adil beu. Kurse nga fundi i majit, komandanti i korpusit të Manastirit, Feti pasha, kishte arritur në Dibër me një regjiment të këmbësisë dhe me një bateri artilerie kodrinore, me qëllim që të demonstronte forcën ndaj kryengritësve të Malësisë së Dibrës⁶². Ndërkaq, më 29 maj, tri regjimente të këmbësisë dhe një batalion gjuajtës me një repart mitralozash shkoi nga Shkupi në Ferizaj⁶³.

Pra, në përputhshmëri me politikën antishqiptare, autoritetet osmane vazhdonin dislokimin e trupave nga Anadollia në Shqipëri, veçanërisht në Kosovë, për të pacifikuar shqiptarët. Në këtë kuadër, Porta e Lartë tani iu afrua në mënyrën më serioze kryengritjes shqiptare. Për këtë flet dhe fakti se Këshilli i Ministrave, mbledhjen e vet e mbajti në Ministrinë e Luftës, që deri atëherë nuk kishte ngjarë kurrë kjo. Lidhur me ngjarjet në Shqipëri, më 25 maj, Porta e Lartë doli me një komunikatë, me anë të së cilës njoftonte se janë dhënë instruksionet e nevojshme që udhëheqësit e kryengritjes të dënohen, kryengritja të shtypet dhe të kthehet rendi. Për komandant të të gjitha trupave osmane që ishin koncentruar rreth Prizrenit dhe Pejës, ishte emëruar gjenerali Abdulla pasha⁶⁴.

Gjithashtu, nga fundi i majit (rreth 28 maj) 1912, sipas "Borbës", situata edhe në krahinën e Dibrës vazhdonte të ishte e tendosur. Basri beu me ithtarët e tij mbante në dorë shumë vise në këtë krahinë. Feti pasha me një regjiment të këmbësisë dhe me një bateri kodrinore nga Manastiri kishte arritur në Dibër, për të demonstruar forcën.

⁵⁹ *Po aty* (Akcija Ise Boletinca), "Borba", Br. 37, Beograd, 16/29.05.1912.

⁶⁰ *Pobuna Arnauta*, "Borba", Br. 30, Beograd, 7/20.05.1912.

⁶¹ *Po aty*, Br. 33, Beograd, 10/23.05.1912.

⁶² *Po aty*, Br. 37, Beograd, 16/29.05.1912.

⁶³ *Po aty*, Br. 30, Beograd, 7/20.05.1912.

⁶⁴ *Spoqašni pregled*, "Borba", Br. 35, Beograd, 12/25,13/26 i 14/27.05.1912.

Njëkohësisht, për qëllime taktike, përderisa t'i bënte të gjitha përgatitjet ushtarake për nënshtrimin e shqiptarëve me forcë, Porta e Lartë si duket edhe më tej do të vazhdon me taktikën e "Komisioneve të ulemave" dhe të "njerëzve autoritativ", do të thotë të instrumentalizimit të kolaboracionistëve. Kështu p.sh. një delegacion i përbërë nga bejlerë, i dërguar nga Haxhi Adil beu, zhvillonte negociata me kryengritësit dibranë që të hiqnin dorë nga kryengritja, por në Malësi të Dibrës ishte një disponim i përgjithshëm kryengritës. Njëkohësisht, siç njofton "Borba", rreth 50 bejlerë ithtarë të xhonturqve, "ndër më autoritativët", nga Peja, Prishtina, Vushtrria dhe Gjakova, rreth 28 maj arritën në Istog, për të zhvilluar negociata me shqiptarët, për t'i bindur ata që të hiqnin dorë nga kryengritja⁶⁵. Megjithatë, të gjitha këto masa ushtarake dhe taktike të ndërmarra nga ana e Portës së Lartë, nuk i zbrapsën shqiptarët nga ideali i lirisë, që do të thotë se në ditët e para të qershorit të vitit 1912 filloi faza e re e Kryengritjes së Përgjithshme shqiptare⁶⁶.

Karakteri i kryengritjes

Gati të gjithë autorët e shkrimeve në gazetën "Borba"; qofshin ato raporte, korrespondenca apo shkrime të natyrës analitiko-publicistike, vënë në dukje se Kryengritja e Përgjithshme shqiptare e vitit 1912, që në fazën e parë, për nga karakteri i saj dallon nga kryengritjet paraprake, gjatë viteve 1908-1911. E veçanta e kësaj kryengritje ishte se:

- Në dallim nga kryengritjet e deritashme, kur ato kryengritje kishin karakter lokal-krahinor e fisnor, kjo kryengritje i tejkaloi suazat lokale-krahinore dhe u ngrit në kryengritje të përgjithshme shqiptare, që shtrihej, apo s'paku ndjehej, nga kufijtë më të skajshëm veriorë deri në kufijtë më të skajshëm jugorë të Shqipërisë (Arnautllukut).

- Ndërsa kryengritjet e mëparshme ishin të udhëhequra nga bajraktarë të paemancipuar, të cilët e kishin dhe fjalën kryesore në negociatat me pushtetin osman, kjo kryengritje drejtohej nga një udhëheqësi politike e vetme kombëtare e shkolluar, me në krye Ismail Qemalin dhe Hasan Prishtinën. Gjegjësisht, kryengritjes iu bashkuan dhe

⁶⁵ *Pobuna Arnauta* (Radi pregovora s Arnautima) "Borba", Br. 37, Beograd, 16/29.05.1912.

⁶⁶ Sh. Rahimi, *vep. e për.*, Enti i i Historisë së Kosovës - Zavod za istoriju Kosova, Kryengritjet shqiptare në Kosovë më 1909-1912, Kosova-Kosovo, nr. 1, Prishtinë-Prishtina, fq. 83-85.

i prinin asaj një pjesë e elitave; intelektuale, politike, ekonomike etj. të shoqërisë shqiptare të kohës, duke i dhanë asaj "vulën e veçantë" me dimensione të reja në planin ideor dhe në atë organizativ.

- Kryengritja kishte programin e veçantë ideor, që përcaktonte karakterin e saj politik; të luftës çlirimtare që do të duhej të kurorëzohej me fitimin e autonomisë së Shqipërisë.

Kështu, ndër personalitetet e dalluara të jetës shoqërore, në nivel lokal dhe kombëtar, që iu bashkuan kryengritjes dhe të cilët përmenden në faqet e gazetës "Borba" ishin: Nga Prizreni, kandidatët për deputet të opozitës: Musa Efendiu dhe Haki aga, imam Hafis Hasani, Sadi aga, Bajram Rogova si dhe një numër i parisë së Prizrenit. Nga Shkupi, Halim beu (Deralla), kandidat për deputet i partisë opozitare, ish-komisar policie dhe redaktor i gazetës "Shkupi", si dhe vëllai i tij që ishte nëpunës në Shkup. Nga Vushtrria, apo siç shkruan "krenaria shqiptare", ish deputeti Hasan Prishtina së bashku me pesë vushtrrias më autoritativ, ndër ta edhe Zejnulla beu. Të gjithë këta rrokën armët dhe iu bashkangjitën kryengritësve. Duket se kështu veproi edhe Nexhip Draga, kurse për Dervish Himën nuk dihej se nga Dibra ku shkoi. Kur kësaj t'i shtohet se në taborin kryengritës ndodhet edhe Ismail Qemali, siç e quan autori "spirtus rektor" i Lëvizjes Kombëtare shqiptare, i cili së bashku me udhëheqësit e fiseve në kryengritje: Abdyl Qerim Bunjakun, Halil Beqir Bunjakun, Bajram Daklanin, Mahmud Zaimin dhe prijës të tjerë, atëherë Lëvizjes Shqiptare domosdo do t'i pranohet edhe ideshmëria dhe serioziteti i plotë.

Pra, kjo ishte kryengritja popullore shqiptare më serioze deri më tani, vlerësohej në gazetën "Borba"⁶⁷. Sepse kryengritja shqiptare tanimë kishte një objektiv të caktuar në nivel të perfeksionuar, vlerësonte autori tjetër, "Orlansky". Autonomia e Shqipërisë ishte objektivi sublim i kryengritjes shqiptare, siç vlerësonte autori "Spoljashnji". Në këtë kuadër, Ismail Qemali nga malet e Rugovës dhe Hasan Prishtina nga Zveçani, nëpërmjet proklamatave ftonin popullin shqiptar "në luftë për çështjen e shenjtë shqiptare, për lirinë e popullit shqiptar"⁶⁸.

⁶⁷ *Arbanskoj pokreta*, "Borba", Br. 36, Beograd, 15/28.05.1912.

⁶⁸ *Arbansko pitanje*, "Borba", Br. 30, Beograd, 7/20.05.1912; Noviji arnautski pokret, "Borba", Br. 37, Beograd, 16/29.05.1912.

Pikërisht në këto dimensione të reja të kryengritjes shqiptare, “Borba” e mbështeste tezën e vet mbi rrezikimin serioz të interesave strategjike serbe në Shqipëri, në veçanti në Shqipërinë e veriut.

S u m m a r y

THE NEWSPAPER "BORBA" ON THE FIRST PHASE OF THE ALBANIAN GENERAL UPRISING DURING APRIL-MAY 1912

The bibliographical data and the political considerations that are accounted in the pages of newspaper “Borba” could be a complementary reference for the progress of the scientific thought on the first faze of the Albanian uprising of 1912. According to same newspaper “Borba”, the reasons and the motives of the uprising were of social, cultural, political and national character, but the sublime goal was the autonomy of Albania. The uprising broke out during the middle of April of 1912 in Guci and in the region of Dukagjini. During the first half of May of 1912 frontal combats were conducted in the frontline of Prizreni-Gjakova-Peja-Mitrovica. Meanwhile the main battles were conducted in Ura e Shenjtë, amid Prizreni and Gjakova, and then somewhere amid Gjakova and Peja, as well as in the village Istog, amid Peja and Mitrovica. In the mean time frontal combats were conducted in Dibra e Vogël. Alongside the vilayet of Kosova and Shkodra during the second decade of May of 1912 the uprising spread quickly in the vilayets of Manastiri and Janina, or in the rest of Albania (Arnavutluk). During the third decade of May the Albanians substituted the tactic of frontal war with that of guerrilla war of small armed groups what made very difficult the suppress of the uprising. For the defeat of the uprising Istanbul took unsuccessful political and military measures.

The Albanian uprising of 1912, from the first phase was lead from a cohesive national headship headed by Ismail Qemali and Hasan Prishtina. In the uprising were incorporated not only the masses but also part of the Albania’s society elites such as intellectuals and politicians etc. giving it a unique identity of serious dimensions in the ideological and organisation perspective.